



Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Prodato Received / Delivery	14.12.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMESHCK	7461/2023		115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1361/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1361/2023 të datës 31.10.2023 e parashtruar nga ankuesi me adresë rruga

kundër organit të punësimit/Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1361/2023 e datës 31.10.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Shfuqizohet Vendimi KA.nr.32/2023 i datës 29.09.2023 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

III. Anulohet Njoftimi për përzgjedhjen përfundimtare i datës 30.08.2023 për pozitën "Zyrtar për Arkiv 1 në Prokurorinë Themelore në Prizren", faza e testimit me gojë dhe me shkrim si dhe Raporti i përgatitjes së listës së ngushtë.

IV. Obligohet Komisioni Përzgjedhës në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të ndër marr veprimet e nevojshme në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, që të zhvilloj procedurën e rekrutimit për pozitën Zyrtar për Arkiv 1 në Prokurorinë Themelore në Prizren, nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë.

V.Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, që të kujdeset që zbatimi i këtij vendimi të bëhet si në pikën IV të dispozitivit.

VI.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Prokurorial i Kosovës, më datë 28.07.2023 ka shpallur konkursin me Nr. KPK/SKPK/ZKPSH/PSRK/PTH/POZ-015 për pozitën "Zyrtar për Arkiv 1 në Prokurorinë Themelore në Prizren", në të cilin ka aplikuar edhe ankuesi, i cili është përfshirë në listën e shkurtër dhe në fazën e testimin me shkrim dhe intervistën me gojë. Pas përfundimit të procedurës më datë 30.08.2023 është publikuar njoftimi për përzgjedhjen përfundimtare, ku në bazë të tij rezulton se ankuesi nuk është kandidat i suksesshëm, ngase sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve ankuesi është vlerësuar me gjithsej 71.9 pikë duke u renditur i treti në listën përfundimtare.

Ankuesi kundër vlerësimit të rezultatit përfundimtar, më datë 22.09.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës më datë 29.09.2023 ka nxjerr Vendim KA.nr.32/2023 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi listën e kandidatëve të suksesshëm të datës 30.08.2023.

Ankuesi, kundër Vendimit KA.nr.32/2023 të datës 29.09.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes postës më datë 27.10.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila më datë 31.10.2023 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.1361/2023 me numër protokollit 6789/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, 01.11.2023 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariatit i Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 06.11.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave me rastin e kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6789/2023 të datës 31.10.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e rezultateve të testit me shkrim datës 25.08.2023 dhe 23.08.2023; Njoftimin për kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë 18.08.2023; Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare i datës 30.08.2023; Konkursin e datës 28.07.2023; Zarin e datës 27.10.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.11.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 06.11.2023; Vendimin KPK.Nr.193/2023 i datës 23.02.2023; Kërkesën për autorizim të publikimit të

shpalljes i datës 27.07.2023; Vendimin DPSKPK/Nr.342/2023 i datës 17.08.2023; Vendimin DPSKPK/Nr.349/2023 i datës 18.08.2023; Vendimin DPSKPK/Nr.357/2023 i datës 22.08.2023; Regjistrin e aplikacioneve të pranuarra i datës 15.08.2023; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit me shkrim datës 22.08.2023; Testin me shkrim të ankuesit dhe kandidatës F.H i datës 22.08.2023; Formulari i vlerësimit individuale të intervistës me gojë datë 25.08.2023; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës me gojë datë 25.08.2023; Renditjen përfundimtare të kandidatëve e datës 25.08.2023; Ankesën e datës 22.09.2023 të ankuesit; Vendimin KA.nr.32/2023 të datës 29.09.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Kërkesën për punësim të ankuesit, Diplomën me Nr. 5840, Kontratë për punë praktike vullunetere e datës 01.03.2019, Referencë e datës 20.06.2022, Rekomandim i datës 18.10.2021, Referencë e datës 18.10.2021, Certifikatën e datës 09.04.2022, Pasqyrën e llogarisë nga trusti për periudhën 16.07.2021-17.07.2023, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 20.07.2023, Dokument identifikimi; Kërkesën për punësim të kandidatës F.H, Akt Emetimin e datës 03.11.2022, Diplomën me Nr. 1325, Vërtetim për punë i datës 15.08.2022, Vërtetimin e datës 01.06.2016, Referencë e datës 05.07.2020, Formularin për vlerësimin e punës provuese i datës 02.02.2023 Certifikatën mbi dënimet penale e datës 02.08.2023, Dokument identifikimi; Deklaratën e kandidatës F.H; Kontratë pune për kohë të caktuar e datës 01.09.2020 dhe Certifikatën e ARBK-së e datës 01.03.2017.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin në vijim kolegji i Këshillit), pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar, *sepse*:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.32/2023 të datës 29.09.2023 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, pretendon se janë shkelur parimet e pranimit nëpunësve civil sipas Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, duke pasur favorizime për kandidaten e përzgjedhur.

Në bazë të konkursit me Nr.KPK/SKPK/ZKPSH/PSRK/PTH/POZ-015 për pozitën "Zyrtar për Arkiv 1 në Prokurorinë Themelore në Prizren" të shpallur më datë 28.07.2023 nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial i Kosovës, kriteret kanë qenë të përcaktuar "Diplomë universitare; Dy (2) vite përvojë pune".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil si dhe duke u bazuar në nenin 86 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative", do të bëjë shqyrtimin në tersi të procedurës së rekrutimit për pozitën Zyrtar për Arkiv 1 në Prokurorinë Themelore në Prizren.

Bazuar në shqyrtimin e tërësishëm të kësaj procedure, si dhe gjatë analizimit të dosjeve të kandidatëve të përzgjedhur dhe ankueses të dërguar nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial i Kosovës, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi më rastin e aplikimit për këtë pozitë ka dërguar dokumentacionet e tjera e që në bazë të tyre rezulton se për nga përgatitja profesionale posedon Diplomën me Nr. 5840 të datës 16.10.2018 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me të cilën dëshmohet se më datë 25.08.2018 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik duke marr titullin *Jurist i Diplomuar-Bachelor*, ndërlidhur me përvojën e punës i njëjti ka dorëzuar Kontratë për punë praktike voluntare VU.Gj.A.Nr.01-2019-6 të datës 01.03.2019 për kryerjen e punës praktike në Gjykatën Themelore në Prizren nga data 01.03.2019 deri më datë 28.02.2020, Referencën e datës 20.06.2022 të lëshuar nga _____ për përvojë punë nga data 01.06.2021 duke vazhduar e të cilën e ka mbuluar me dëshmi nga pasqyra e llogarisë nga trusti për periudhën 16.07.2021-17.07.2023.

Kandidatja e suksesshme F.H, me rastin e aplikimit për këtë pozitë ka dorëzuar dokumentacionin e përgatitjes profesionale respektivisht sipas Diplomës me Nr.1325 të datës 15.04.2019 të lëshuar nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", me të cilën dëshmohet se më datë 21.11.2016 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Ekonomik duke marr titullin *Bachelor i Arteve në Administrim Biznesi-Kontabilitet*, ndërlidhur me përvojën e punës e njëjta ka dorëzuar Akt Emërimin e datës 03.11.2022 të lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës për përvojën e punës nga data 03.11.2022 deri më datë 02.02.2023, Vërtetimin e lëshuar nga TEB për kryerjen e praktikës nga data 06.01.2020 deri më datë 05.07.2020, Vërtetimin për punë të lëshuar nga Fabrika për Përpunimin e Masave Plastike të datës 15.08.2022, Vërtetimin e datës 01.06.2026 të lëshuar nga ATK për kryerjen e praktikës nga datës 04.05.2016 deri më datë 20.05.2016. Duke marr parasysh dëshmitë e përvojës e punës respektivisht sa i përket përvojës së punës në Fabrikën për Përpunimin e Masave Plastike nga data 01.09.2020 e deri në lëshimin e vërtetimit për punë të datës 15.08.2022, ndërsa kjo kandidate konfirmon se ky është biznes familjar me konkretisht i babait të saj dhe i njëjti është i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, duke dërguar edhe kontratën e marrëdhënies së punës mirëpo të njëjtën nuk e ka përcjell me rastin e aplikimit, mirëpo nuk ka dërguar asnjë vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe dëshmi të lëshuar nga Trusti Pensional i Kosovës si dokument mbështetës i kësaj përvojë, ri rrjedhojë, Kolegji i Këshillit konstaton se kjo është përvojë punë në një institucion privat dhe duhet të mbështetet me dokumentet përkatëse nga këto institucione, siç është theksuar me Aktvendimin me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022 të Gjykatës së Apelit e Kosovës, e cila ka theksuar se: "dëshmitë e përvojës së punës duhet të dëshmohen me kontratë pune dhe me vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe dëshmi të lëshuar nga Trusti Pensional i Kosovës, detyrim ky ligjor i përcaktuar me nenin 9 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale".

Nga konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.32/2023 i datës 29.09.2023, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit (të aplikuar në këtë periudhë) Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së

Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, prandaj mbi këtë bazë i njëjti është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit, nga konstatimet e lartcekura, konstaton se për shkak të shkeljeve procedurale të potencuara si më lartë në këtë procedurë, atëherë dhe me qëllim të eliminimit të tyre, Komisioni Përzgjedhës në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, është i obliguar të ndërmarr veprimet e nevojshme në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, që të zhvilloj procedurë të rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Arkiv 1 në Prokurorinë Themelore në Prizren, nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë dhe të bëjë vlerësimin e aplikacioneve të kandidatëve duke u bazuar në konstatimet si më lartë dhe gjithë herë në respektim të normave të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1361/2023, datë 14/12/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së